

SI TË MARRËSH VENDIME TË MENÇURA?

Gjashtë Hapat e Besimit (3)

Jakobi 1:7-8

Perëndia na çon në rrethana të ndryshme në jetë, që të na mësojë sesi ta njohim Atë. Perëndia lejon problemet, presionet dhe vështirësitë; të gjitha llojet e situatave në jetët tona që të na ndihmojë ta njohim më shumë Jezus Krishtin, Zotin tonë. Ai ka një plan shumë specifik, një proces për jetën e secilit.

Dhe nëse nuk e kupton këtë proces nuk mund të bashkëpunosh me Të. Unë po e quaj këtë proces Gjashtë Hapat E Besimit:

Ëndrra. Vendimi. Vonesa. Vështirësitë. Rrugë pa Krye. Plotësimi

Para dy javësh ne pamë Hapin, (Fazën e Parë)—Ëndrrën, vizionin. Perëndia të jep ty një ëndërr për jetën tënde. Vjen një moment në jetë, kur ty të hapen sytë dhe shikon se çfarë synimi ka Perëndia për jetën tënde. Ti fillon ta dallosh qartë planin e Tij, qëllimin e Tij. Ti nuk je këtu në tokë rastësisht.

Pra, fillon kur ti e kupton ëndrrën e Perëndisë, çfarë do Perëndia të bëjë në jetën tënde.

Por, ëndërra është e pavlerë nëse ti nuk zgjohesh dhe ia fillon punës për ta realizuar, nëse ti nuk vendos për t'i shkuar pas kësaj ëndërr.

Ne sot jemi në Hapin 2, **Hapi i Vendim-marrjes Me Besim.**

Ne na pëlqejnë personat që i marrin vendimet shpejt. Ne mendojmë se ata persona që i marrin vendimet shpejt, janë të zgjuar. Por, shpejtësia e marrjes së një vendimi nuk është gjithmonë gjëja më e rëndësishme. Është më e lehtë të marrësh një vendim të shpejtë, sesa të marrësh një vendim të mirë. Nuk është ndonjë gjë e madhe të marrësh një vendim të shpejtë, por duhet goxha urtësi nga Zoti të jesh në gjendje të marrësh vendimin e duhur.

Bibla flet shumë për marrjen e vendimeve.

Jakobi 1:7-8 *"Dhe ky njeri të mos pandehë se do të marrë diçka nga Zoti, sepse është një njeri me dy mendje, i paqëndrueshëm në gjithë rrugët e veta."*

Bibla thotë që njeriu me dy mendje është shkatërrimtar, ai që është i pavendosur nuk ka për të provuar dot më të mirën që ka Perëndia për të. Vargu thotë: *"as të mos i shkojë mendja se do të marrë ndonjë gjë nga Perëndia."* Nëse unë nuk vendos dot se çfarë është më e rëndësishme për jetën time, atëherë unë jam duke e kufizuar dorën e Perëndisë në jetën time dhe po i sjell vetes shkatërrim, po humb më të mirëm që ka Perëndia për mua dhe kjo gjë nuk më lë të piqem në karakter.

Vendimet tona përcaktojnë të ardhmen tonë, karakterin tonë—nëse do të rritet ose shkatërrohet.

Kur e di cila është ëndërra e Perëndisë për ty, atëherë vjen Hapi i dytë *"si të marrësh vendimin e duhur?"*

SI TE MARRESH VENDIME TE MENÇURA

Gjashte Fazat e Besimit (3)

Perëndia i dha Moisiut ëndrrën që të nxirrte popullin e Izraelit nga skllavëria 400 vjeçare. Por Moisiu duhet të merrte vendimin të përballej me Faraonin. Perëndia i dha Noeut ëndrrën e shpëtimit të botës, nga përmytja e shiut. Por, Noeu duhet të merrte vendimin për të ndërtuar arkën. Perëndia i dha Abarhamit ëndrrën për fillim e një kombi të ri krejt nga fillimi, por ishte Abrahami ai që duhet të vendoste të linte çdo gjë pas; çdo gjë që kishte-rehatinë, sigurinë që i jepte vendi i tij, dhe të ikte drejt një vendi të panjohur. Ti nuk ke për t'u përballur kurrë me ëndrrën e vërtetë që ka Perëndia për jetën tënde nëse nuk arrin ta kalosh këtë Hap të besimit, marrjen e vendimit.

Bibla është plotë me shembuj se çfarë efekti sjellin vendimet e mençura. Unë dua të jap një shembull në lidhje me rëndësinë e vendim marrjes sepse ne tentojmë ti marrim vendimet me shumë ngut, pa u menduar shumë. Pastaj do t'ju jap një shembull Biblik, të thjeshtë, që mund ta bëjë kushdo, sesi t'i marrësh vendimet të bazuar nga Bibla. Ky lloj modeli përfshin çdo lloj vendimi që do të duhet të marrësh, qoftë vendim për punë, qoftë vendim për t'u martuar, në lidhje me shëndetin, fëmijët, të ardhmen, lekët.

Tek Fjala e Perëndisë ka parime sesi të marrësh vendime të mençura për çdo lloj rasti.

Si Të Marrësh Vendime Të Mençura? - GJASHTË HAPA

1. Lutu Për Udhëzim Nga Perëndia

Para se të bësh diçka, kërkoi Perëndisë se cila është perspektiva e Tij, në lidhje me atë gjë që je gati të vendosësh. *"Kush i beson zemrës së tij është budalla, por ai që ecën me urtësi (e Perëndisë) do të shpëtojë."* **Fjalët e Urta 28:26**

Sa nga ju keni marrë vendime koti; por kur vendosët ju duk sikur ishte gjëja më e mirë që duhet të bëjë? Ne të gjithë krijojmë përshtypjet tona në lidhje me diçka—por përshtypjet janë vetëm përshtypje. Ato nuk vijnë nga Perëndia, por vijnë nga mënyra sesi ndjehesh për momentin, ose atë ditë—ide që të vijnë për momentin në kokë. Të duhet diçka më shumë sesa intuita, më shumë sesa: *"Unë mendoj që do të veproj kështu..."* Ty të duhet e vërteta absolute në të cilën ta bazosh vendimin tënd. Ty të duhet udhëzimi i Perëndisë. *"Paqja e Perëndisë... të mbretërojë në zemrat tuaja."* **Kolosinëve 3:15**

Një përkthim tjetër thotë: *"Kjo paqe të drejton drejt vendimeve që duhet të marrësh."*

Pyete Vetën: *"Çfarë do Perëndia nga unë?"* dhe jo *"çfarë dua unë vetë nga vetja ime"?*

2. Mblidh Fakte

Besimi dhe faktet nuk e kundërshtojnë njëri-tjetrin, gjej çdo informacion që të duhet para se të marrësh një vendim. *"Çdo njeri i matur vepron me dituri."* **Fjalët e Urta 13:16**

Mblidh çdo fakt që ke mundësi të gjesh.

"Kush jep përgjigje për një çështje para se ta ketë dëgjuar, tregon marrëzinë e tij (budallallikun)...!" **Fjalët e Urta 18:13**

SI TE MARRESH VENDIME TE MENÇURA

Gjashte Fazat e Besimit (3)

Fakte nga jeta; 90% e të gjitha bizneseve të reja dështojnë brenda vitit të parë. Pse? Sepse janë të bazuar në atë që po e quaj, entuziazëm i paedukuar. Ata kanë një ide fantastike por nuk kalojnë kohë të mbledhin informacion në lidhje me idetë e tyre.

Prandaj, shumë fejesa dhe martesë prishen. Në Shqipëri 10% e të martuarve ndahen në vitin e parë të martesës, sepse janë të bazuar në entuziazmin e paedukuar—që e quajnë dashuri “*unë të dua ty ti më do mua, hajde martohemi*”. Në Shqipëri çdo ditë 4 çifte divorcohen.

Pyete Vetën: “Çfarë duhet të di para se ta marr këtë vendim?” - thamë çfarëdo vendimi qoftë.

3. Pyet Të Tjerë Për Këshilla.

Bisedo me dikë që ka marrë të njëjtin vendim, bisedo me shokë/shoqe që i njohin dobësitë e tua, kërko këshilla, “...Në numrin e madh të këshilltarëve është fitorja.”

Fjalët e Urta 24:6

Pyetën Henry Ford, themeluesi i kompanisë motorike Ford

- “Cili është sekret i suksesit? Ai tha: “Të marrësh vendime të Mençura.”

- Po si mësohet që të marrësh vendime të mençura? “Nga përvoja.” - Po përvoja si fitohet?

- “Duke marrë vendime koti.”

Është gjë e mirë të mësosh nga përvoja, por është mençur të mësosh nga përvojat e të tjerëve. Kërko këshilla. Për shkak se unë nuk kam kohë të mësoj çdo gjë nga përvoja ime, nuk kam kohë të bëj gjithë ato gabime që të mësoj nga to, atëherë do të pyes të tjerë që kanë kaluar të njëjtën gjë para meje. Jeta është e shkurtër nëse ti do të mësosh vetëm nga gabimet dhe gjërat që ke provuar vetë. Unë nuk duhet të provoj disa gjëra (mëkate) sepse e di që janë gjëra të këqija për mua, sepse unë shikoj rezultatet që kanë në jetën e të tjerëve. Ti mund të mësosh nga sukseset dhe dështimet e dikujt tjetër.

Të gjitha historitë që gjendet në Bibël na janë dhënë që të mësojmë dhe të rritemi nëpërmjet tyre. Mëso të kërkosh këshilla. Bibla thotë: “*Planet bëhen të qëndrueshme nga këshilla; prandaj bëje luftën me këshilla të urta.*” **Fjalët e Urta 20:18**

Problemi është se ne më shumë duam që të dukemi të mençur sesa të jemi të mençur.

Ne mendojmë që po të pyesësh të tjerët do të duket më shumë budallallëku ynë.

Por është më e rëndësishme të jesh, sesa të hiqesh si i mençur, sikur i di të gjitha.

Bibla thotë që njerëzit e mençur, kërkojnë këshillën e dikujt tjetër. Nëse ti nuk kërkon dot këshillën e dikujt, ti ke probleme me ‘egon’. Bibla thotë: “*Njerëzit arrogantë janë budallenj.*”

Janë budallenj sepse nuk duan të mësojnë. Nëse ti nuk je i mësueshëm nuk ke për të patur sukses në jetë. Sepse të gjithë ne jemi të paditur në disa fusha të jetës. Prandaj,

SI TE MARRESH VENDIME TE MENÇURA

Gjashte Fazat e Besimit (3)

duhet të pyesim njëri-tjetrin dhe të kërkojmë ndihmën e njëri-tjetrit. Bibla thotë, që *“Mençuria dhe përulësia ecin së bashku.”*

Pyete veten: *“A e kam të lehtë apo të vështirë të kërkoj këshillën e dikujt?”*

4. Llogarit Cmimin.

Çdo vendim që merr ti e ka një çmim, një etiketë. Madje dhe ato vendimet e vogla që të duken shumë të vogla. Sa herë që ti harxhon qoftë edhe një minutë ndaj diçkaje ti po harxhon një pjesë të jetës tënde në atë gjë. Ajo minutë nuk kthehet më. Sa herë që ti jep kohën, aq herë ti je duke dhënë jetën tënde pas asaj gjëje. Ti mund të fitosh më shumë lekë nesër, por nuk mund të fitosh më shumë kohë. Sepse ti ke një sasi të caktuar ditësh, vitesh.

Çdo vendim e ka një çmim. Ka për të kushtuar ty kohë, energji, lekë, reputacion, talentet e tuaja, aftësitë e tua, burimet që ke. Gjithmonë je duke investuar diku. *“Është një kurth për njeriun të marrë një zotim(vendim) pa u matur mirë dhe mbasi ta ketë marrë, të mendohet.”* **Fjalët e Urta 20:25**

Do të biesh në kurth nëse vendos për diçka pa biseduar, ose merr një vendim pa e menduar më parë, apo të marrësh një përkushtim pa e marrë në konsideratë çmimin e atij përkushtimi. Nëse dikush të shtyn, të bën presion për të vendosur për diçka, mos u ndiko. Sepse e rëndësishme është të marrësh vendimin e duhur dhe jo një vendim të shpejtë.

Dua që çdo njeri që në këtë kishë merr vendimit për të pranuar Krishtin të mos ngutet, por të marrë parasysh më parë se çfarë ka thënë Krishti për të, përfitimet që të ofron Ai nëse ti ia jep jetën Atij, atëherë ky vendim ka për të qenë vendimi i duhur.

Gjithmonë ka për të qenë si një kurth nëse ti merr një vendim pa e marrë në konsideratë më parë çmimin. Një nga rregullat e jetës është, gjithmonë është më e lehtë për të hyrë brenda sesa për të dalë jashtë. Është më e lehtë për të filluar një miqësi sesa të dalësh prej saj. Është më e lehtë për të hyrë në borxh sesa për të dalë prej tij. Është më e lehtë për të filluar një zakon sesa për të dalë prej tij. Është më e lehtë të fillosh diçka sesa ta përfundosh. Llogarite çmimin!

Jezusi tha, asnjë njeri nuk ndërton një shtëpi, pa u ulur më parë të llogarisë sesa do ti kushtojë. Ai tha, asnjë mbret nuk shkon në luftë pa llogaritur më parë ushtarët dhe pa u siguruar nëse dalin apo jo për ta fituar luftën.

Pyete Vetën: *“A ia vlen?”*

Dikush tha: *“Për të arritur sukses në jetë janë dy gjëra kyçe. Një, vendos se çfarë do të bësh në jetë. Dy, vendos a je gati për të paguar çmimin që kërkon ajo gjë.”* - sepse çdo vendim e ka një çmim.

SI TE MARRESH VENDIME TE MENÇURA
Gjashte Fazat e Besimit (3)

5. Përgatitu për Problemet Që Do Të Dalin

Donald Trump (një miliardë amerikan) ka thënë, *"Unë pres më të mirën por përgatitem për më të keqen."* Kjo nuk është këshillë e keqe. Me besim, ti prit më të mirën. Prit që Perëndia do të punojë, do të veprojë në jetën tënde. Por, gjithashtu përgatitu për problemet që do të vijnë. 3.000 vjet më parë, Solomoni tha të njëjtën gjë në Bibël: *"Njeriu i matur e shikon të keqen dhe fshihet; por njerëzit naivë shkojnë tutje dhe dënohen."* *"Njeriu i matur i shikon problemet që po vijnë drejt tij dhe përgatit veten si të merret me to, ai që është budalla nuk i shikon kurrë ato dhe vuan pasojat."* **Fjalët e Urta 22:3**

Njeriu i mençur e kupton që pas çdo vendimi që merr, kanë për të dalë probleme dhe përgatitet për to. Nëse do t'i injorosh problemet, ato nuk do të injorojnë ty. Problemet janë të pashmangshme, ata janë pjesë e jetës. I mençuri përgatitet për to.

Pyete Vetën: *"Në këtë vendim që po marr unë, çfarë mund të shkojë keq? Nëse diçka shkon keq çfarë ka për të ndodhur?"*

Ka një ndryshim të madh mes, përgatitjes ndaj një problemi dhe zgjidhjes së një problemi. Mos i ngatërro këto dy Hapa të Besimit, Hapi i Vendim-Marrjes me Hapin e Zgjidhjes së Problemeve. Janë dy gjëra të ndryshme. Nëse do të duhet t'i zgjidhësh të gjitha problemet para se të marrësh një vendim ke për t'u paralizuar përpara sesa të vendosësh.

Në jetën shpirtërore, kjo do të thotë që ty nuk të duhet zgjidhësh të gjitha dyshimet në lidhje me Krishtërimin dhe Krishtin para se të vendosësh *"a do ti besosh, a do ta ndjekësh Krishtin apo jo?"* Por ajo që bën dikush, kur pranon Krishtin, thotë një lutje të tillë, *"Jezus unë ta jap jetën time, me aq sa kuptoj unë, me aq sa njoh veten time dhe Ty, unë jam gati ta jap jetën time, dhe të ndjek Ty çdo ditë."*

Gjatë jetës, ti merresh me problemet që dalin gjatë saj, dyshimet që dalin. Unë akoma nuk kuptoj çdo gjë që thuhet në Bibël.

Nuk duhet të sqarosh të gjitha dyshimet para se të vendosësh. Një njeri erdhi tek Jezusi një herë dhe i tha: *"Unë dua që Ti të vish dhe ta shërosh djalin tim."* Jezusi e pyeti: *"A beson ti që Unë mund ta shëroj?"* Ky burri i tha: *"Unë dua të besoj, dhe dua që Ti ta ndihmosh mosbesimin tim, dyshimet e mia."* Jezusi tha: *"Kjo është e mjaftueshme"*, dhe në moment ia shëroi djalin. Nëse kjo ishte e mjaftueshme për këtë burrë, është e mjaftueshme edhe për ty. Ti vjen tek Zoti dhe i thua, *"Jezus, unë ta jap Ty jetën time. Unë nuk kuptoj çdo gjë, dhe unë kam disa frikëra dhe disa dyshime. Por unë po vij tek Ti kështu siç jam."* Ti ke për të zgjidhur problemet më vonë. Nëse duhet t'i zgjidhësh të gjitha problemet para se të marrësh një vendim, atëherë i bie që ai vendim nuk është marrë me besim.

SI TE MARRESH VENDIME TE MENÇURA

Gjashte Fazat e Besimit (3)

Por, përse të kesh frikë, sa herë që merr një vendim? Kjo lloj frike është një frikë që nuk ke si ti shmangesh, sepse duhet të tregohesh i kujdesshëm kur hedh hapin e fundit.

Historia e Davidit, biznesmen, sesi ai dhe grupi i tij, besojnë tek Zoti, luten, tregojnë të tjerëve për Të, dhe e duan Zotit duke e nderuar me punën e tyre.

Pyete Vetën: *“A je naiv, apo përgatitesh për problemet, nuk habitesh kur ndodhin, je gati për t’u marrë me to?”*

6. Përballu me Frikërat

Frika është rrënja e çdo vendimi të paqëndrueshëm. Është frika se ti mund të gabosh, që ty s’do të eci, që ti do të dështosh, që ty do të vij turp nga vetja? A është frika ajo që të pengon, se ti s’duhet ta marrësh atë përkushtim nëse nuk e mban dot? Frika se dikush do të qeshi me ty, dikush do të kthejë krahët ty për shkak të përkushtimit që ti ke marrë. Gjithmonë, gjithmonë është frika që të të mban larg dhe të bën të jesh i pavendosur.

Ne nuk duam ta pranojmë që kemi frikë, kështu që nxjerrim justifikime. Moisiu i tha Zotit, *“Unë nuk flas dot, më mbahet goja.”* Gideoni tha, *“Unë jam më i riu i shtëpisë time.”* Abrahami tha, *“Unë jam shumë i vjetër.”*

Cili është justifikimi yt? Nëse akoma nuk ia ke dorëzuar jetën totalisht Jezusit, çfarë frike ke? Nëse nuk je pagëzuar, çfarë frike ke? Pas çdo vendimi të paqëndrueshëm është frika në lidhje me diçka, nuk ka rëndësi sesi justifikohemi ne.

Perëndia ka një ëndërr për jetën tënde dhe Jezus Krishti do që të jetë pjesë e jetës tënde. Disa nga ju po thonë: *“Unë nuk kam kohë, Unë nuk kam përvojë, Unë nuk kam lekë, Unë nuk kam shkollën e duhur, Unë nuk kam shoqërinë e duhur, Unë nuk kam burime të mjaftueshme.”*

Është frika që po të mban ty larg vendimit që Perëndia po të nxit të marrësh, mjaft u justifikove, vendos. Bëj atë që kërkon Perëndia nga ty.

“Kush e ka mendjen tek era nuk ka për të mbjellë dhe kush rri e shikon retë nuk ka për të korrur.” **Predikuesit 11:4**

Kush pret për kushte të përsosura, nuk ka për të bërë asgjë.

Perfeksionizmi i paralizon mundësitë, potencialet. Perëndia gjithmonë ka përdorur njerëz me dobësi të ndryshme, në situata krejt të papërshtatshme për të plotësuar vullnetin e Tij. Gjithmonë. Nëse ti je duke pritur për personin e përsosur që të martohet me ty—ai nuk ka për të ardhur kurrë. Nëse ti je duke pritur për situata perfekte, kur gjërat të jenë ashtu siç i do ti, apo kur të të bëhet ty mbajr diçka në mënyrë që ti t’ia përkushtosh veten tënde Krishtit—nuk ka për të ndodhur kurrë.

Përkushtimet bazë të jetës duhet të merren në mes të jetës së përditshme.

SI TE MARRESH VENDIME TE MENÇURA

Gjashte Fazat e Besimit (3)

Pse? Sepse jeta vazhdon, nuk të pret ty.

Cila është e kundërta e frikës? Besimi.

"Në qoftë se Perëndia është me ne, kush mund të jetë kundër nesh?" Romakëve 8:31

Ti ke besim tek Perëndia dhe lëviz përpara, hidh hapin para. Pavarësisht nga problemet, frikërat, dyshimet. Sekretin është të lëvizësh përmes frikës, të bësh atë gjë që ke frikë më shumë. Nëse ti e di që ajo gjë është vullneti i Perëndisë dhe ti e di që Perëndia të ka dhënë ty një ëndërr, merre vendimin, qepju pas dhe ec përmes frikës; ke për të parë sesi Deti i Kuq do të hapet dhe ke për të parë sesi Perëndia do të sigurojë manat për ty; ke për të parë sesi Perëndia do bëjë mrekulli në miqësitë e tua, tek problemet e tua, tek financat e tua, apo çfarëdo gjëje që të jetë.

Kur unë nuk kam shumë besim për të bërë diçka, unë eci para dhe e bëj atë gjë, gjithsesi, sikur ta kisha besimin. Dhe besimi shtohet tek unë.

Ka momente që unë dyshoj shumë gjëra, por gjithsesi eci përpara, pavarësisht se kam frikë, dhe besimi vjen, konfidenca ime në Zotin shtohet.

Para çfarë vendimi ndodhesh ti sot? A je para vendimit për ta pranuar Krishtin? Për t'u pagëzuar? Për të bërë seminarin e rradhës? Apo, Perëndia po të kërkon diçka tjetër? Të ndryshosh vendin e punës, apo të fillosh diçka nga e para? **Unë të përgjërohem ty sot**, bëj gjëra të mëdha me jetën tënde, për hir të Jezu Krishtit.

Mos e harxho kot jetën tënde. Mos jeto një jetë të rëndomtë, duke u angaris, sepse të gjithë po angarisen, sa me ngryset ditët.

Merri vendimet që do të përcaktojnë të ardhmen tënde. Zoti do që ta ndryshojë këtë qytet nëpërmjet nesh.

Përgjatë gjithë historisë, kush ka sjellë ndryshim në botë? Kush e ka nxitur zhvillimin? Isak Njutoni i besonte Krishtit, Galileo Galilei i besoi Krishtit. Gjergj Fishta, Fan Noli. Kush i filloi shkollat e para në perëndim, spitalet e para, fondacionet e para? Kush e filloi shkollën e parë shqipe në Korçë, përveç se motra e Gjerasim Qiriazit, pastorit të kishës ungjillore në atë qytet, pastori i parë i atij brezi, pastori guximtar.

Perëndia do ta ndryshoi këtë qytet, do ti japë një faqe të re këtij vendi, dhe Ai do ta bëjë nëpërmjet të krishterëve, nëpërmjet teje.

Pse? Përse do që të përdorë Perëndia të krishterët? Sepse ata ia kanë dhënë jetën Krishtin, duan të bëhen si Ai, ata kanë zemrën e Tij, dhe i shohin gjërat, i bëjnë gjërat ashtu si do ti bënte Ai. Sepse kisha është trupi i Krishtit në Tiranë, Kisha janë duart, këmbët, sytë, mendja e Krishtit.

Ju përgjërohem me gjithë zemër, kërkojini Zotit ëndërra të mëdha për jetën tuaj, nëse akoma nuk ke kaluar kohë me Të për këtë gjë. Nuk kushton asgjë të

SI TE MARRESH VENDIME TE MENÇURA

Gjashte Fazat e Besimit (3)

ëndërrosh. Ainshtajni ka thënë: “*Imagjinata (ëndërrimi), është më e mirë se njohuria.*”

Kur ti sigurohesh se çfarë do Perëndia nga ty, merr vendimin për ta bërë atë gjë realitet, qepju pas, sepse Perëndia është me Ty, kush mund të jetë kundër teje? Sepse me Perëndinë çdo gjë është e mundur, sepse do të bëhet sipas besimit tënd.

Si të sigurohem që po marr vendimin e duhur?
Merr në konsideratë 6 hapat e mësipërm.

Ka katër vendime jetëndryshuese që çdo person i kësaj kishe duhet të marrë, duhet të vendosë:

1. Përkushtoje jetën Krishtin dhe bëhu pjesë e familjes së Tij. Ti duhet t’ia japësh jetën Jezus Krishtit. Nëse nuk ia ke dhënë nuk ke se pse pret më, është vendimi më i madh në jetë, sepse nga ai vendim varet përjetësia jote.

Ka shumë kisha të mira në Tiranë, ka 26 kisha të tjera në Tiranë, përveç kishës tonë, bëhu pjesë e një kishe patjetër, nëse do të rrish në këtë kishë bëhu anëtar.

2. Përkushtohu, merr vendimin për pjekuri shpirtërore, zakonet e rritjes frymërore. Mos jini një i krishterë i vakët, i cekët, mos anashkalo të shkuarit në kishë apo leximin e Biblës. Përkushtohu, hidhe hapin. Bëhu ashtu siç do Perëndia që të bëhesh. Nxirr nga jeta jote çdo gjë që do Perëndia që ti të nxjerrësh, formo karakterin që do Perëndia. Ky përkushtim kërkohet nga të gjithë ju që jeni bërë anëtar.

3. Përkushtohu në përdorimin e dhuntive, talenteve, aftësive në shërbimin ndaj Perëndisë dhe të tjerëve. “Mos hajdeni thjesht për të qëndruar ulur.”

4. Përkushtohu që do ti tregosh të tjerëve për Jezus Krishtin. Kur ti e njeh lajmin e mirë, ti duhet të bëhesh lajmëtar, ambasador, përcjellës, transmetues i Lajmit të Mirë.

Kisha e Tiranës është e formuar në bazë të këtyre katër përkushtimeve. Ne jemi këtu që të ndihmojmë ty pasi t’i kesh marrë këto vendime. Unë nuk vendos për ty.